



Nr. 1137/3 Prot.

Durrës më 06 / 05 /2026

V E N D I M

Nr. 36 Datë 06 / 05 2026

P Ë R
"MIRATIMIN E TARIFAVE PËR PROCESIN E FITIMIT TË TITUJVE
AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të VKM-së nr. 112 datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" të ndryshuar; në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së; në Rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të KPPPA-së, bazuar në Vendimin nr. 6, datë 08.04.2026 të KPPPA-së, si dhe në relacionin nr. 932 prot., datë 16.04.2026 të Drejtorisë Juridike, vendimi të Senatit Akademik nr.56, datë 20.04.2026, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave për procesin e fitimit të titujve akademikë si më poshtë:
 - a) Tarifa e aplikimit për të gjithë aplikantët në vlerën 5000 (pesë mijë) lekë;
 - b) Tarifa për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" në masën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë;
 - c) Tarifa për fitimin e titullit akademik "Profesor" në masën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;
 - d) Aplikantët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, të përjashtohen nga pagesa e tarifave të pikës b) dhe c), për fitimin e titujve akademikë.
2. Ngarkimin për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Ada ALIAJ

